

Deklaratë për Shtyp



BANKA E SHQIPËRISË

Zyra e Shtypit
16 prill 2010

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur
(në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim fiks	R/REPO mujore	R/REPO tremujore
01.10.2009	18,950.00		
08.10.2009	17,580.00		2,820.00
15.10.2009	18,630.00		4,460.00
22.10.2009	21,535.00		5,000.00
29.10.2009	17,840.00	3,000.00	
05.11.2009	17,320.00	3,000.00	
12.11.2009	19,250.00		
19.11.2009	18,650.00		
26.11.2009	22,120.00		
03.12.2009	25,310.00		
10.12.2009	17,440.00		
17.12.2009	16,290.00		
24.12.2009	19,920.00		
31.12.2009	22,310.00	3,000.00	

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për të injektuar likuiditetin, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor* mesatarisht 19.51 miliardë lekë* në javë si dhe instrumentet rregullues me maturim më të gjatë se një javë - *marrëveshjen e riblerjes me maturim një dhe tre-mujor*. *Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim një-mujor* u përdor në 3 raste, mesatarisht 3.0 miliardë lekë për ankand).

Edhe *marrëveshja e anasjelltë tremujore* u përdor në tre raste, mesatarisht 4.1 miliardë lekë për ankand. *

Me qëllim rritjen në mënyrë të përhershme të likuiditetit në treg, Banka e Shqipërisë organizoi gjatë muajit dhjetor një ankand për blerjen me të drejta të plota, nëpërmjet të cilit u injektuan 2.35 miliardë lekë.


Përdorimi i instrumenteve mbështetës

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009, depozita njëditore u përdor mesatarisht 0.54 miliardë lekë në ditë, në krahasim me 0.35 miliardë lekë në ditë gjatë tremujorit të kaluar. Përdorimi i depozitës njëditore ishte më intensiv gjatë ditëve të fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore gjeti një përdorim minimal gjatë këtij tremujori (një rast përdorimi në nivelin 10 milionë lekë).

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2009.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2009 (me çmim blerjeje).



*Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e katërt të vitit 2009 Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor dhe nuk ka kryer veprime me bankat e nivelit të dytë.

Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Kështu, shitjet me Ministrinë e Financave gjatë tremujorit i katërt llogariten në 3.09 miliardë lekë. Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave për këtë periudhë ishte 0.48 miliardë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 90.9 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	475.01	3,093.53
TE TJERA (IDA, IBRD)	90.93	